



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.802/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me procesëmbajtësen Nexhmije Abazxhik, në konfliktin administrativ, të paditësit DPT. D. nga P. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: rivlerësim i shpenzimeve transportit, në seancën publike të mbajtur me datë 18.07.2017, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të përfaqësueses ligjore të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit DPT. D. nga P.

ANULOHET aktvendimi nr.07.3/173 datës 11.03.2015 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R1908/03.02.2015, R539/13.01.2015, R1566/29.01.2015, R1011/21.01.2015 të ZBD Prizren, si e pa bazuar.

Paditësi DPT. D. nga P., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 06.05.2015, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovohet padia e paditësit, të anulohet aktvendimi i të paditures 07.3/173 dt. 11/03.2015 dhe ti kthehet paditësit shuma e paguar në emër të shpenzimeve të ngritura të transportit.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaron: aktvendimi i atakuar i Doganës së Kosovës përmban shkelje ligjore dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Qendra e pranimit në mënyrë të kundërligjshme ka rritur shpenzimet e transportit detar ku kanë llogaritur shpenzimet në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.04/2014. Dogana e Kosovës nuk e ka arsyetuar vendimin e vet pasi që vendimi është i përgjithësuar dhe nuk jep sqarime të bazës ligjore dhe asaj faktike. Me rastin e deklarimit të mallit në kemi paraqitur fakturat e transportit të paditësit, kontratën e transportit, pagesat e shpenzimeve të transportit, por e paditura këto prova nuk i merr për bazë, dhe vendos që të refuzoj ankesën tonë. Pika 4 e Udhëzimit administrativ nr.04/2014, e shqaron se vetëm në rastet kur kontestohet ndonjë nga komponentët mund të aplikohet një metod tjetër e vlersimit. Dogana e Kosovës po ashtu ka dështuar në zbatimin të nenit 2 të pikës 4 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2014 e cila e obligon të padituren, që të lëshoj procesverbal për konstatimin e gjendjes faktike në kuptimin e vlerës së shpenzimeve të transportit

Përfaqësuesja ligjore e të paditures Ministria e Drejtësis- Avokatura Shtetërore në përgjigje në padi datës 20.02.2017 deklaron: e kontestojm në tërësi kërkespadinë e paditësit si të pabazuar. Vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjisllacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë

të vetme. E paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim me të cilin refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin e të paditues.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se përfaqësuesja ligjore e të paditues me parashtrësën e datës 18.07.2017 ka njoftuar gjykatën se nuk mund të marr pjesë në seancë dhe propozon që të veprohet konform nenit 38 par.5 i LKA-së (provë: parashtrësë nga Ministria e Drejtësisë dt.18.07.2017).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 18.07.2017, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e datës 20.02.2017 nga Ministria e Drejtësisë, aktvendimi nr.07.3/173 i datës 11.03.2013 nga Dogana e Kosovës, deklaratat unike doganore, fakturat e mallit, fakturat e shpenzimeve të transportit, pagesat bankare, kontrata për transportin e mallërave.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 18.07.2017, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, deklarimeve dhe provave të paraqitura në seancë dhe konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar andaj vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata vëren se e paditura Sektori Për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R1908/03.02.2015, R539/13.01.2015, R1566/29.01.2015, R1011/21.01.2015 të ZBD Prizren, konfirmon rivlerësimin e shpenzimeve të transportit nga zyra doganore, me arsyetimin se paditësi ka paraqit vlera më të ulta për shpenzime të transportit të mallit nga sa është dashur ti paraqiste. Dokumentacionin e paditësit e ka konsideruar të pamjaftueshëm sepse paditësi nuk ka paraqit kontratë të shitblerjes me eksportuesin që do të përcaktonte kushtet e dërgesës, nuk ka paraqit deklaratë eksportuese, nuk ka paraqit kontratë me transportuesin. Udhëzimi administrativ nr.04/2014, e ka të rregulluar koston e shpenzimeve të transportit të mallit.

Në procedurën e konfliktit administrativ, paditësi i ka paraqit gjykatës provat materiale si: faturat e shpenzimeve të transportit, faturat e mallit, pagesat bankare datës 06.02.2015 të realizuara në Bankën TEB, të cilat përmbajnë edhe numrat e faturave të transportit, kontrata për transportin e mallrave e lidhur mes paditësit dhe transportuesit R. L.L.C. nga P..

Edhe pse paditësi ka cekur në ankesën e tij datës 20.02.2015 se posedon pagesat e transportit, e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve nuk ka marr për bazë fare këto pretendime të paditësit për të vlerësuar se a janë paguar shpenzimet transportuesit të mallit.

Dispozita e nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2014 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve Transportit të Mallrave të Importuara, ka paraparë elementet që duhet marrë parasysh gjatë shqyrtimit të Deklaratës unike doganore lidhur me paritetin, dhe në pikën 3.4 të kësaj dispozite janë cekur edhe dokumentet që kërkohen lidhur me paritetin e mallit si: kontrata, fatura, mënyra e pagesës dhe dëshmi tjera.

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore gjykata konstaton se e paditura nuk është dashur të refuzoj ankesën e paditësit vetëm për shkak se paditësi nuk posedon kontratë me eksportuesin apo nuk ka paraqit deklaratën eksportuese. Për ti vërtetuar konstatimet e veta e paditura, se paditësi ka paraqit vlera më të ulta të shpenzimeve të transportit të mallit, është dashur që ti shqyrtoj pagesat bankare që ia ka paraqit paditësi në procedurën administrative të ankesave, dhe të konstatoj se këto pagesa a janë të harmonizuara me vlerën e faturave të transportit. E paditura nuk ka mbështetur konstatimet e veta me argumente se paditësi i ka paguar eksportuesit vlera më të ulta për shpenzimet e transportit se sa vlera e shpenzimeve të deklaruara, përderisa paditësi në procedurën e konfliktit administrativ i ka paraqit gjykatës dokumentacionet përcjellëse të mallit të lartcekura të cilat nuk janë shqyrtuar fare në procedurën administrative të ankesave.

Gjykata nga këto prova që i ka paraqit pala paditëse edhe në procedurën administrative të ankesave, nuk mund të kuptoj nga arsyetimi i vendimit kontestues pse nuk janë shqyrtuar faturat e shpenzimeve

transportit dhe pagesat bankare, me të cilat paditësi pretendon se vlera e deklaruar është vlerë reale e paguar për shpenzimet e transportit.

Prandaj me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, me prova materiale shtesë, lidhur me kontestin e vërtetësisë së dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, gjykatës i duhet sqarim plotësues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar të mbështetet në prova materiale.

Gjykata kërkon nga e paditura Sektori i Rishqyrtimit të Vendimeve-Dogana e Kosovës që në riprocedurë të shqyrtoj dokumentacionin përcjellës të mallit që kërkohet me dispozitat e nenit 3 pika 3.4 të Udhëzimit Administrativ nr.04/2014 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve Transportit të Mallrave të Importuara, ashtu që të shqyrtohet validiteti i faturave të shpenzimeve të transportit të deklaruar nga paditësi, urdhërpagesat kombëtare datës 06.02.2015, kontratën për transportin e mallrave të lidhur me transportuesin R. LLC nga P.. E paditura të nxjerr konstatimin se vlera e deklaruar e shpenzimeve transportit është e harmonizuar apo jo me vlerën e transfereve bankare dhe dokumentacioneve përcjellëse të mallit, dhe varësisht nga gjendja e konstatuar të nxjerr vendim të ri ligjor.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos kontestimit të vërtetësisë së dokumentacionit të mallit të prezantuar në procedurën administrative të ankesave. Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga neni 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejt të çështjes.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.802/15 datë 18.07.2017

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.